



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 77-të, të mbajtur më 14.11.2022, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Denoncimi me numër 12-8853/1 i datës 19.10.2022, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Denoncimi të dorëzohet për veprim kompetent Këshillit Gjyqësor të RMV-së dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të RMV-së.

Lënda me numër 12-8853 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-8853/1 të datës 19.10.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Akuzat e bëra në denoncim kanë të bëjnë me dyshimet për kryerje joprofesionale dhe të pakujdesshme të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale nga gjyqtarët dhe prokurorët publikë në /// dhe ///, dhe në lidhje me një ngjarje ligjore penale, ku i dyshuari është parashtruesi dhe vëllai i tij ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Nga mbikëqyrja në përmbajtjen e denoncimit dhe provave të dorëzuara , KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk elemente për veprim kompetent. Autoritetet kompetente të autorizuara ligjërisht për të shqyrtuar akuzat në kërkesë janë Këshilli Gjyqësor i RMV-së dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të RMV-së, gjë që është e nevojshme për t'ua përcjellë atë autoriteteve.

Bazuar në të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:  
Parashtruesi

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: Mr.Sh. S

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЕ  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Kryetare,  
Biljana Ivanovska

